

FJALA E DEPUTETIT LUÇIANO BOÇI

E ENJTE 7 TETOR 2021

Para meje një përfaqësuese e maxhorancës i krahasoi deputetët e opozitës me “lacat e lagjes”. Në fakt, përtej kuptimit pezhorativ që ka ky përcaktim, kam një këshillë për ju: para se ta përmendni këtë term ose togfjalësh, si të doni quajeni, ju duhet të lani gojën, sepse ata “lacat e lagjes” ju i mbani në vendin e parë të makinës; ata “lacat e lagjes” i keni përdorur në fushata elektorale si patronazhistë; ata “lacat e lagjes” i keni punësuar të gjithë në shtet, se fusin kartën dhe marrin paratë pa e ditur se ku punojnë. Është këshillë miqësore para se të bëni të tilla krahasime.

Dalim te problemi, te mënyra sesi e keni menaxhuar ju pandeminë. Po përfitoj nga situata, nga ana vizuale, e dini si e keni menaxhuar, në sytë e publikut? Si ky akti normativ sot, ku njëri flet, tjetri voton, njëri i bie gozhdës, tjetri i bie patkoit dhe ku pjesa më e madhe e kabinetit qeveritar për një çështje kaq sensitive, sa gati po qante këtu për shëndetin e publikut, mungon. Ky është serioziteti juaj i menaxhimit të pandemisë? Megjithatë nuk mjafton kjo, e di shumë mirë.

Po e ilustruj me një shembull nga fusha e arsimit. E dini si e keni menaxhuar pandeminë, përtej fjalëve lavdëruese kilometrike? Si një klasë kolektive, ku nxënësit vijnë nga cikle të ndryshme dhe asnjëri prej tyre nuk merr kujdesin e duhur nga mësuesi, jo se mësuesi nuk e bën dot punën, por është si në rastin tuaj, mësuesi është i paaftë, është i babëzitur, i pangopur, si qeveria. Ky është realiteti. Thënë troç, ju nuk ia keni varur asnjë njeriu, si ai mësuesi i klasës kolektive. Nuk ia keni varur, sepse realisht e latë biznesin në mëshirë të fatit, e varfëruat, e denigruat biznesin dhe në fund u kujtuat për disa paga më shumë, që në bazë të llogaritjeve janë paga që çdo njeri do t’i merrte te zyra e punës, ato pagat tremujore. Dhe jo vetëm biznesin, i latë mjekët të përleshën me vdekjen, si mallkim të fatit të tyre me maska të skaduara, me veshjet të përdorura, të pavaksinuar për një kohë të gjatë dhe të gjithë njerëzit i latë në mëshirë të fatit, në duar të matrapazëve të çdo lloji, në duart e atyre që bënin teste me çmime stratosferike, si dhe në duart e lloj-lloj skifteri grabitës, duke u marrë atyre nga xhepat dhe qindarkën e fundit. I hodhët nxënësit, mësuesit, studentët, pedagogët, prindërit e tyre në një betejë krejtësisht të pabarabartë me një armik të padukshëm dhe vini sot dhe mburreni.

Mburreni, për çfarë, se unë nuk e kuptoj dot? Mburreni se jemi vendi që kemi vdekshmërinë më të lartë? Për çfarë mburreni? Mburreni se kemi një vit e gjysmë në pandemi dhe ende nuk janë vaksinuar të gjithë mësuesit, nuk janë vaksinuar të gjithë pedagogët, nuk janë vaksinuar studentët dhe jo më të flasim për pjesën e mbetur të popullit? Mburreni për çfarë? Se në shkollat tona sot nuk ka asnjë masë për mbrojtjen kundër COVID-it, nuk mbrohen se klasat janë kapicë, janë me nxënës më shumë dhe janë me turne, për këtë mburreni? Mburreni se keni shtyrë vitin akademik? E keni shtyrë se gjoja jua kërkoi konferenca e rektorëve. Po, e kërkoi konferenca e rektorëve, sepse nuk kishte gati auditorët dhe aspak për ta shfrytëzuar javën për vaksinimin e studentëve, është propaganda juaj kjo. Kërkesa e konferencës së rektoreve ishte shumë e thjeshtë. Mburreni, sepse sipas statistikave zyrtare keni vaksinuar 28% të popullsisë, e pranoi edhe ministrja dhe jo me të gjitha vaksinat e pranuar nga BE-ja. E tha edhe zoti Shehu, e keni bërë sallatë ruse vaksinimin. Por desh harrova, ajo që mburreni vërtet, dua të citoj zotin Vasili: “Ju mburreni me konkluzionet e Akademisë së Shkencave”, të akademisë së Gjinushit, pasi keni 8 vjet që mbillni injorancën këtu. Çfarë bëri Gjinushi? Rropi nga buxheti i shteti 22 milionë lekë dhe bëri një studim fantastik, që dua ta citoj. I keni lexuar konkluzionet? Se po t’i kishit lexuar konkluzionet shkencore të Akademisë së Shkencave, sot do të flisnit ndryshe. Dhe sipas konkluzioneve shkencore të zotit Gjinushi, 73% janë të imunizuar dhe në qoftë se vazhdoni të lexoni

pak më poshtë, në konkluzione theksohet se, në qoftë se ne vaksinojmë vetëm 20% të popullsisë, atëherë jemi në rregull, kemi arritur standardin e BE-së. Por ne kemi vaksinuar 28%, sipas Gjinushit, duke bashkuar edhe qeverinë, ne jemi te 90% e sipër, pra jemi në rregull fare. Këto reklama ndoshta nuk do të duheshin fare, ndoshta jo kaq milionë vaksina, sepse ana shkencore funksionon. I bëtë njerëzit çorap. Kë të besojmë, Gjinushin apo Ramën, që mburret për detyrën që ka si Kryeministër ndaj shëndetit të publikut? E konsideron si nder personal, duhet t'ia dimë për nder, ne si opozitë, qytetarët, se falë tij, se po të mos ishte ai, Shqipëria do ishte shuar tashmë. Pra, kjo është situata që ju keni mbjellë. Jo vetëm kaq. Po, pandemia është murtajë, por murtaja më e madhe, që është bombë sociale, është murtaja në arsim, keni mbjellë injorancë, e cila do të shpërthejë dhe do jetë më e gjatë. Faleminderit!